



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.22.09.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Nazlije Shala dhe Bajram Hashani

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinet të Kryetarit të Komunës

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Dhënia në debar publik e Draft Rregullores “Programi trevjeçar për Banim në Komunën e Obiliqit”
4. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për vitin 2023
5. Miratimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që të ndryshohet dhe plotësohet rend i ditës, do të thotë në pikën e 6-të, të jetë propozim vendimi nr.1270 për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Obiliq dhe në pikën e 7 të jetë propozim vendimi nr.1271 për shpallje me interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në zonën kadastrale në Obiliq.

Miratohet rendi i ditës me 5 vota për dhe 2 vota abstenim me ndryshimin dhe plotësimin e cekur më lartë.

### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 5 vota për dhe 2 vota kundër.

### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet dhënien në debat publik të Draft Rregullores “Programi trevjeçar për Banim në Komunën e Obiliqit”.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që Draft Rregullorja “Programi trevjeçar për Banim në Komunën e Obiliqit” të delë në debat publik.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi që kjo Draft Rregullore të delë në diskutim publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal dhënien në debat publik të Draft Rregullores “Programi trevjeçar për Banim në Komunën e Obiliqit” të delë në debat publik.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet Propozim vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2023.

**Enver Gashi** – Edhe ne pajtohemi që ky propozim vendim të shkoj në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për vitin 2023.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për aprovimin e buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që buxheti të shkoj në Kuvend, ku edhe do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** – Mendoj se do të ishte mirë që buxheti për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025, të jetë më i specifikuar sa i përket shpenzimeve të buxhetit, prandaj duhet të specifikohet. Nëse, në seancë të Kuvendit buxheti nuk vjen i specifikuar, atëherë ne nuk do ta aprovojmë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim buxhetin për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025 me specifikime.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, për aprovimin e propozim vendimit me nr.1270, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Obiliq.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim propozim vendimin nr.-II-1270, të dt.20.09.2022, për shpalljen me interes të përgjithshëm për shpronësimin e Nësive kadastrale P-72614055-01279-5 dhe P-72614055-01279-12, në zonën kadastrale në Obiliq.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, për aprovimin e propozim vendimit me nr.1271 për shpallje me interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në parcelën kadastrale P-72614055-00631-24, në zonën kadastrale në Obiliq.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim propozim vendimin nr.-II-1271, të dt.20.09.2022, për shpalljen me interes publik për objektet të cilat gjenden në parcelën kadastrale P-72614055-00631-24 në zonën kadastrale në Obiliq.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Ministria e financave, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-78, të dt.30.05.2022, për aprovimin e kërkesës së Klubit Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit” për mbështetjen financiare të projekt propozimit për blerjen e pajisjeve për këtë klub për zhvillimin e sportit të paraglidingut si atraksion i ri në Komunën e Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim shfuqizimin e vendimit nr.-I-78, të dt.30.05.2022, për aprovimin e kërkesës së Klubit Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit” për mbështetjen financiare të projekt propozimit për blerjen e pajisjeve për këtë klub për zhvillimin e sportit të paraglidingut si atraksion i ri në Komunën e Obiliqit.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Naim Krasniqi, nga grupi lokal i veprimit për një lokal për zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe propozon që kjo kërkesë ti dërgohet DPUKP-së.

**Enver Gashi** – Ne kemi thënë edhe më heret që kërkesat ti drejtohen Drejtorive përkatëse.

**Sami Ahmeti** – Derisa qytetarët na drejtohen neve, edhe ne mundemi ti shqyrtojmë kërkesat, por mirë kishte me qenë që edhe drejtorët të jenë prezentë në mbledhje.

**Kryesuesja** – Edhe drejtorëve, ua dërgojmë materialin komplet sikurse juve për mbledhjet që i mbajmë.

E kemi një kërkesë nga Arianit Gimolli, nga fshati Bakshi për plotësimin e infrastrukturës dhe rrugës në gjatësi prej 1000-1300 metra dhe me gjerësi prej 2 metrave.

Kjo kërkesë i dërgohet Drejtorisë për infrastrukturë lokale.

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Arianit Gimolli lidhur me ujërat e zeza.

Kjo kërkesë i drejtohet DSHPE-së, për shqyrtim.

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Nazmi Smaili, -OVL-në Obiliq, për ndihmë financiare në shumën prej 8,500 €.

Kjo kërkesë dërgohet në DEFZH dhe DSHPE, për shqyrtim dhe në Kuvend të vijë me një njoftim.

**Pika 9 e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** – Do të doja, që në seancën e ardhshme të na njoftoni lidhur me shtëpizat e vendosura në shesh, që të kemi përgjegje nga Drejtoria përkatëse.

**Bajram Hashani** – Salla e edukatës fizike në gjimnaz është rregullue, por kërkohet mundësisht që të pajiset me mjete për gjimnastikë.

**Sami Ahmeti** – Materiali që na u dorëzue sot ne mbledhje, kishte me qenë mirë të na dërgohet përmes emailit, por nuk e kemi kuptuar kërkesën e Klubit Aeronautik.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:38'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

